

RAPORT NGA MONITORIMI

I GJYKIMEVE TË RASTEVE TË


DHUNËS NË FAMILJE

NË KOSOVË

Korrik 2024

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



RAPORT NGA MONITORIMI

I GJYKIMEVE TË RASTEVE TË

DHUNËS NË FAMILJE

NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE.....	5
2. METODOLOGJIA	8
3. KORNIZA LIGJORE	9
4. KONSTATIMET NGA MONITORIMI GJYQËSOR	13
4.1 Mbështetja e tepërt e gjykatave themelore tek dënimet alternative dhe analizimi i pamjaftueshëm i faktorëve rëndues dhe lehtësues në rastet e dhunës në familje	13
4.2 Dështimi i gjykatave themelore për t'i gjykuar rastet e dhunës në familje në kohë	18
4.3 Mangësitë në zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.....	21
5. PËRFUNDIME	23
6. REKOMANDIME	25

LISTA E SHKURTESAVE

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
KPP	Kodi i Procedurës Penale
QPS	Qendra për punë sociale
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
UME	Urdhër për mbrojtje emergjente
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
ADK	Akademia e Drejtësisë e Kosovës
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
LMDHF	Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UM	Urdhër për mbrojtje

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.¹ Sipas raportimeve të mediave, që nga viti 2010 të paktën 55 gra të Kosovës janë vrarë nga partnerët apo të afërmit e tyre meshkuj, pra afërsisht një vrasje çdo tre muaj.²

Ky raport analizon të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2023 nga ana e programit për monitorim të gjykimeve të Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) të lidhura me gjykimin e veprave penale dhe kontesteve civile të dhunës në familje në Kosovë.³ Raporti synon të vlerësojë në ç'skallë shtatë gjykatat themelore të Kosovës⁴ i respektojnë standardet ligjore vendore dhe ndërkombëtare gjatë shqyrtimit të rasteve të dhunës në familje. Ai synon të shërbejë si mjet didaktik për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, dhe ofron rekomandime përkitazi me trajnimet, si edhe rekomandime tjera, për Akademinë e Drejtësisë të Kosovës (ADK), Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK) dhe institucionet tjera përkatëse të Kosovës.

Në përputhje me mandatin e OSBE-së dhe metodologjinë e mirëkonsoliduar të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), ky raport bazohet në gjetjet nga 141 raste të dhunës në familje në procedurë civile dhe penale që janë monitoruar drejtpërsëdrejti nga OSBE-ja në periudhën 1 janar - 1 dhjetor 2023. Analiza është shërbyer me gjetjet e pesë qendrave rajonale të OSBE-së, ku që të gjithat kanë personel që monitoron rregullisht shqyrtimet gjyqësore në shtatë gjykatat themelore. Si e tillë, OSBE është në pozitë unike për ta analizuar shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje nga gjykatat e Kosovës.

Një nga gjetjet kryesore është se afatet procedurale respektohen në shumë pak prej rasteve të monitoruara, duke ngritur kështu shqetësime për sa i përket

1 Ministria e Drejtësisë e Kosovës 2022, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026. Gjetet tek <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf> (qasur më 24 tetor 2023).

2 Radio Evropa e Lirë "55 gra të vrara në 13 vjet". Gjetet tek <https://www.evropaelire.org/a/gra-te-vrara-kosove/32157504.html> (qasur më 1 dhjetor 2023).

3 Për qëllime të këtij raporti (përveç rasteve kur theksohet ndryshe) përkufizimet e sjelljes që përbëjnë ose "kualifikohen" si dhunë apo keqtrajtim në familje përfshijnë veprat e mëposhtme të gjetura në Kodin Penal të Kosovës të kryera brenda marrëdhënies familjare: vrasja (neni 172), vrasja e rëndë (neni 173), kanosja (neni 181), ngacmimi (neni 182), ngacmimi seksual (neni 183), sulmi (neni 184), lëndimi i lehtë trupor (neni 185), lëndimi i rëndë trupor (neni 186), privimi i kundërligjshëm i lirisë (neni 193), dhunimi (neni 227), sulmi seksual (neni 229), degradimi i integritetit seksual (neni 230), keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës (neni 243), shkelja e detyrimeve familjare (neni 244), dhe dhuna në familje (neni 248).

4 Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Gjakovë, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Gjykata Themelore në Gjiilan dhe Gjykata Themelore në Ferizaj.

sigurisë së viktimave, si dhe të drejtës së të pandehurve për gjykim në afat të arsyeshëm, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës. Me të vërtetë, gjykimi i drejtë dhe i shpejtë i rasteve të dhunës në familje është thelbësor për të garantuar respektimin e të drejtave për gjykim të drejtë të parapara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Me rastin e vlerësimit nëse procedurat penale janë në pajtueshmëri me nenin 6, gjykatat e shqyrtojnë procedurën në tërësi, përfshirë të drejtat e mbrojtjes, interesat e publikut dhe të viktimave për ndjekje penale të mirëfilltë dhe, po të jetë e nevojshme, të drejtat e dëshmitarëve.⁵

Të dhënat shpalosin po ashtu se, ndonëse praktikat e dënimit ndryshojnë, praktikë e zakonshme e gjykatave⁶ është që të shqiptojnë dënim alternativ me kusht ose gjobë. Gjuha e thjeshtë e Udhëzuesit për politikën ndëshkimore (Në tekstin e mëtuftjeshëm Udhëzuesi) sqaron se dënimet me kusht janë të përshtatshme në disa situata, por mund të perceptohen si "lirim i plotë i kryerësit nga të gjitha përgjegjësitë pa pasoja" dhe se për çdo dënim alternativ gjykatat duhet të ofrojnë arsyetim që është i thukët dhe që dëshmon se zëvendësimi do t'i plotësojë njëllot qëllimet e dënimit.⁷ Udhëzuesi saktëson më tej se dënimi me kusht duhet të përdoret vetëm për vepra penale "*që nuk janë të rënda* dhe kur kërcënimi me dënim të jetë i mjaftueshëm për ta parandaluar kryerësin nga kryerja e një veprë tjetër" (theks i shtuar). OSBE është e shqetësuar se praktika e përhapur dhe shpeshherë e paarsyetuar e shqiptimit të dënimeve me kusht në Kosovë mund t'i shkurajojë viktimat e dhunës në familje që ta raportojnë keqtrajtimin dhe të rezultojë në mosndëshkim të kryerësve, duke shpërthyer në rrezik për përsëritje të veprës.

Masat mbrojtëse shqiptohen nga gjykata civile ose policia dhe ngërthejnë një gamë të gjerë mjetesh juridike, përfshirë këtu ndalimin e afrimit ose ngacmimit të viktimës, duke kërkuar që kryerësit t'i nënshtrohen trajtimit psikosocial, të varësisë nga drogat ose alkooli, si dhe masa mbrojtëse pasurore.⁸ Të dhënat tregojnë se, ndonëse gjykatat e Kosovës i miratuan shumicën e kërkesave të parashtruara për urdhërmbrojtje (UM) që përfshijn te miturit, në shumicën e seancave përfaqësuesit të QPS nuk morën pjesë edhe pse kanë obligim ligjor.

⁵ *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* (nr. 9154/10), §§ 100-101/2015, 15 dhjetor 2015 (qasur më 24 tetor 2023).

⁶ Për hir të koncizitetit dhe konsistencës, ky dokument do t'u referohet veprimeve të ndërmarra nga "gjykata", megjithëse Kodi i Procedurës Penale i Kosovës parashih që çështjet penale gjykohen ose nga gjyqtari i vetëm gjykues ose nga trupi gjykues i kryesuar nga kryetari i trupit gjykues.

⁷ Kosovë, Gjykata Supreme e Kosovës, *Udhëzues për politikën ndëshkimore, Botimi i parë*, 2018. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing_Guidelines_shkurt_2018.pdf, fq. 164-165. (qasur më 24 tetor 2023).

⁸ OSBE (pa datë), Katalogu i këshillave dhe asistencës për viktimat e dhunës në familje, <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/88708.pdf> (qasur më 1 dhjetor 2023).

1. HYRJJE

Që nga viti 1999, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka qenë i mandatuar për monitorimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë për pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të gjykimit e drejtë dhe me të drejtat e njeriut. Nëpërmjet monitorimit të gjykimeve, Misioni mëton që ta përmirësojë sundimin e ligjit në Kosovë duke ofruar rekomandime konkrete dhe praktike të tilla si për trajnime apo ndryshime legjislative.

Misioni ka raportuar dhe më herët për shqetësimet në lidhje me dhunën në familje dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke u bazuar në gjetjet e tij nga monitorimi i gjykatave.⁹ Raportet në fjalë patën identifikuar sfida të tilla si zvarritje të konsiderueshme në caktimin e seancave dëgjimore dhe mosshqyrtim të kërkesave për UM dhe urdhra mbrojtje emergjente (UME) brenda afateve ligjore përkatëse. Veç kësaj, monitoruesit e OSBE-së patën raportuar për arsyetimet e mangëta në vendimet për caktim të dënimit dhe dështimin e gjykatave për t'i diferencuar UM-të nga UME-të. Gjithashtu, raportet patën vënë në dukje mangësi në zbatimin e legjislacionit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe keqzbatim të ligjit nga gjykatat, si p.sh. që gjykatat në mënyrë të gabuar i inkurajonin palët në rastet e dhunës në familje të pajtoheshin, apo kishte probleme lidhur me të drejtën për procedurë të hapur për publikun. Me qëllim të rritjes së vetëdijes për mjetet juridike në dispozicion të viktimave të krimit, në veçanti viktimave të dhunës me bazë gjinore, OSBE organizoi disa punëtori informuese në mbarë vendin. Krahas kësaj, OSBE organizoi punëtori për akterët e sistemit të drejtësisë për fusha tematike të tilla si mbrojtja e viktimave, respektimi i të drejtave të tyre dhe trajtimi i mirëfilltë i rasteve të dhunës në familje.

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.¹⁰ Sipas raportimeve të mediave, nga viti 2010 deri 2023 janë vrarë të paktën 55 gra të Kosovës nga partnerët ose të afërmit e tyre meshkuj, pra rreth një vrasje çdo tre

⁹ Shih p.sh. *Raport i OSBE-së mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë* (korrik 2007). <https://www.osce.org/files/f/documents/8/0/26282.pdf> (qasur më 1 dhjetor 2023); *Raport i OSBE-së për procedurat gjyqësore që përfshijnë dhunën në familje* (nëntor 2009). <http://www.osce.org/kosovo/40398> (qasur më 31 maj 2023); *Raporti reagimi i OSBE-së: Urdhrat për mbrojtje emergjente në rastet e dhunës në familje* (qershor 2011); *Katalog i OSBE-së i këshillave dhe ndihmës për viktimat e dhunës në familje* (mars 2012). <http://www.osce.org/kosovo/88708> (qasur më 1 dhjetor 2023); Shiko gjithashtu *Raport i OSBE-së, Gjykimi i kërkesave për urdhra për mbrojtje në rastet e dhunës në familje në Kosovë* (mars 2012). <https://www.osce.org/files/f/documents/9/5/88713.pdf> (qasur më 1 dhjetor 2023); Shih gjithashtu *Raport reagimi i OSBE-së: Reagimet ndaj rasteve të dhunës në familje duke marrë parasysh vdekjen e znj. Zejnepe Bytyçi-Berisha* (qasur më 1 dhjetor 2015), <http://www.osce.org/kosovo/203051?download=true>

¹⁰ Ministria e Drejtësisë, 2022, *Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026*. Gjetend tek <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf> (qasur më 24 tetor 2023).

muaj.¹¹ Në prill të vitit 2024, Kosova ishte dëshmitare e dy femicideve (vrasje te grave) që ndodhën brenda pak ditësh, që të dyja të kryera në mes të ditës nga bashkëshorti ose ish-bashkëshorti. Shumicës së këtyre epilogjeve fatale u kishte paraprirë një historik i sulmeve a keqtrajttimeve për të cilat ishin vënë në dijeni sistemi i drejtësisë ose shërbimet e tjera mbrojtëse. Kjo e vë në pah rolin vendimtar që kanë gjykatat në trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në familje. Të dhënat e mbledhura nga Ministria e Drejtësisë tregojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës është rritur nga 1,915 në vitin 2019 në 2,638 në vitin 2023.¹²

Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë¹³ e realizuar nga OSBE në vitin 2019 e analizon në mënyrë të hollësishme shkallën e përhapjes së dhunës në familje në Kosovë dhe sinjalizon se këto statistika mund të mos e pasqyrojnë saktë numrin e vërtetë të rasteve të dhunës në familje, i cili ka shumë të ngjarë të jetë shumëherë më i lartë. Gati dy të tretat (64%) e grave që morën pjesë në këtë anketë¹⁴ ishin të mendimit se dhuna e ushtruar nga partnerët, të njohurit, ose të panjohurit, ishte ose tejet ose mjaft e zakonshme, e më tepër se gjysma syresh (54%) deklaruan të kishin përjetuar personalisht dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri intim dhe thujse gjysma besonin se dhuna në familje është çështje private që duhet të trajtohet brendapërbrenda familjes. Shtatëdhjetë e pesë për qind e grave të anketuara, të cilat vinin nga familje që përballeshin me vështirësi të konsiderueshme financiare, pësonin dhunë nga partnerët e tyre aktual.

Përkundër përqindjes alarmuese të të anketuarave që zbuluan se kishin përjetuar dhunë në familje, shumica e grave nuk kishin kontaktuar asnjë shërbim pas rasteve më të rënda të dhunës së ushtruar nga partneri aktual (92%), partneri i mëparshëm (81%) ose personi tjetër përveç partnerit (72%). Vetëm 2% e grave e kishin raportuar incidentin më të rëndë të dhunës së ushtruar nga partneri aktual në polici, 3% tek shërbimet sociale, e thujse asnjëra nuk kishte rënë në kontakt me ndonjë nga strehimoret për gratë a shërbim tjetër të specializuar. Raporti arriti në përfundimin se shkalla e ulët e raportimit të dhunës në familje është e ndërlidhur me turpin e viktimave, mosdëshirën për t'u ndarë nga fëmijët e tyre, mungesën e pavarësisë financiare, frikën nga pasojat nga

11 Radio Evropa e Lirë "55 gra të vrara në 13 vjet". Gjetet tek <https://www.evropaelire.org/a/gra-te-vrara-kosove/32157504.html> (qasur më 1 dhjetor 2023).

12 Baza e të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje. Gjetet tek <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,184> (qasur më 1 dhjetor 2023). Në vitin 2024 në Policinë e Kosovës janë raportuar vetëm 698 raste të dhunës në familje. *Po aty*. Ky raport nuk i analizon të dhënat për vitin 2024 dhe nuk mund të dalë me përfundimi nëse kjo rënie rezulton nga mungesa e besimit të viktimave në sistemin ligjor ose përbën rënie reale të rasteve të dhunës në familje, ose ekziston ndonjë arsye tjetër.

13 Raport i OSBE-së (21 nëntor 2019), *Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë* <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/439781> (qasur më 1 dhjetor 2023).

14 Anketa u realizua me 1,990 gra të moshës 18–74 që jetojnë në Kosovë, përfshirë 1.690 gra që jetojnë në zona të banuara kryesisht nga shqiptarë të Kosovës dhe 300 gra që jetojnë në zona të banuara kryesisht nga serbë të Kosovës.

partneri dhe mungesën e besimit në institucione të tilla si policia, sektori i mbështetjes sociale e i shëndetësisë dhe gjyqësori.

Ky raport synon të ofrojë vlerësim objektiv dhe aktual, të bazuar në fakte, të trajtimit të rasteve të dhunës në familje nga gjykatat e Kosovës, bazuar në analizën e rasteve të monitoruara drejtpërsëdrejti nga ana e monitoruesve të gjykimeve të OSBE-së si dhe parashtresat ligjore e vendimet gjyqësore për periudhën kohore 1 janar - 1 dhjetor 2023.

Ai i identifikon shqetësimet kryesore në vijim:

- Vonesa të tepërta të seancave gjyqësore. Monitoruesit e gjykimeve të OSBE-së raportuan se gjykatat shpesh nuk i respektojnë afatet procedurale të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Raporti do t'i analizojë aspektet përsëritëse të zvarritjeve procedurale dhe do të ofrojë sugjerime për përmirësim.
- Dënimi. Raporti do t'i vlerësojë praktikën e caktimit të dënimit në rastet e dhunës në familje dhe çështjet e lidhura me zbutjen dhe proporcionalitetin e dënimeve. Gjithashtu, raporti do të analizojë nëse dhe në ç'mënyrë gjykatat po e përdorin Udhëzuesin për politikën ndëshkimore, përfshirë zbatimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese.
- Çështjet e lidhura me menaxhimin e rasteve të urdhrave për mbrojtje. Monitoruesit e gjykimeve të OSBE-së kanë vërejtur mangësi në menaxhimin e rasteve, përfshirë këtu mangësi në kuptim të respektimit të afateve kohore dhe mospranisë së pjesëmarrësve të detyrueshëm dhe palëve në gjykime.

2. METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në sa vijon:

- i. Hulumtim i literaturës mbi standardet ndërkombëtare përkatëse të të drejtave të njeriut dhe kornizën ligjore të Kosovës lidhur me dhunën në familje;
- ii. Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të mbledhura nga seancat gjyqësore penale e civile për veprën dhunë në familje, për periudhën 1 janar - 1 dhjetor 2023;
- iii. Analizë cilësore e hollësive tjera të lëndëve, që janë siguruar nga monitoruesit e OSBE-së, nëpër gjykatat në mbarë vendin, të kategorizuara sipas rajoneve;
- iv. Monitorim të drejtpërdrejtë të seancave dhe vlerësim i mbarëvajtjes së tyre nga ana e monitoruesve të OSBE-së.

Monitorimi i gjykimeve konsiderohet gjerësisht si mjet i fuqishëm diagnostikues për vlerësim të mangësive institucionale, strukturore dhe të kapaciteteve të gjyqësorit. Duke mbledhur sistematikisht informata të besueshme për mënyrën në të cilën zhvillohen gjykimet dhe procedurat gjyqësore, këto programe ndihmojnë në zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të drejtësisë sipas standardeve ndërkombëtare të sundimit të ligjit dhe gjyimit të drejtë.

Për qëllime të këtij raporti, monitoruesit e OSBE-së i kanë vëzhguar drejtpërsëdrejti më shumë se 300 seanca në shtatë gjykata themelore të Kosovës në 141 raste të monitoruara nga 1 janari 2023 deri më 1 dhjetor 2023. Pas vëzhgimit të secilës seance dëgjimore për dhunë në familje, monitoruesit kanë futur shënimet në bazën e të dhënave, me analiza të shkurtra të çështjeve kryesore procedurale ose materiale, si dhe i kanë ngarkuar shkresat kryesore gjyqësore, si p.sh. kërkesat për urdhër mbrojtje, aktakuzat dhe aktgjykimet me shkrim. OSBE e ndjek metodologjinë e monitorimit të gjykimeve të ODIHR-it¹⁵ për monitorimin e procedurave në gjykatore dhe parimet kyçe të monitorimit të gjykimeve të tilla si mosndërhyrja në rastet individuale dhe detyrimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe saktësisë.

¹⁵ Metodologjia e monitorimit të gjykimeve e Misionit të OSBE-së në Kosovë bazohet në publikimin e ODIHR-it të vitit 2012, "Monitorimi i gjykimeve: Doracak për referencë për profesionistët," i disponueshëm në <https://www.osce.org/odihr/94216> (qasur më 31 maj 2023).

3. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës garanton një sërë të drejtash e lirish themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht¹⁶, përfshirë të drejtën për jetë (neni 25), barazi para ligjit (neni 24), integritet personal (neni 29), martesë dhe shkurorëzim bazuar në barazinë e bashkëshortëve (neni 37), dhe mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me kushtetutë ose me ligj (neni 54). Kushtetuta i obligon autoritetet publike që të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë personave para ligjit dhe të respektojnë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht.¹⁷ Kështu, neni 7 i Kushtetutës përcakton se rendi kushtetues i Kosovës bazohet në barazi, respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe mosdiskriminim, dhe e mishëron barazinë gjinore si vlerë themelore.

Kodi i procedurës penale i Kosovës (KPP)¹⁸ synon të mbrojë të drejtat për proces të rregullt gjyqësor, përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm;¹⁹ pavarësinë e gjyqësorit;²⁰ dhe pjesëmarrjen në procedurë penale duke përdorur gjuhën amtare dhe ofrim të shërbimeve të përkthimit falas²¹ në gjuhën e vet ose në gjuhën që e kupton.²² Palët e dëmtuara kanë të drejtën për t'u trajtuar me respekt nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose organi tjetër që zhvillon procedurën penale, dhe të drejtën për dëmshpërblim të arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin e shkaktuar me vepër penale.²³ Kur nuk është i mundur kompensimi nga i pandehuri me urdhër të gjykatës, pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë kompensim nga Programi për Kompensim të Viktimave të Krimet.²⁴ Palët e dëmtuara mund të përfaqësohen nga avokati i cili është anëtar i OAK-ut, mbrojtësi i viktimave, ose ta përfaqësojnë veten.²⁵

16 Kushtetuta e Kosovës, Kapitulli II – Të drejtat dhe liritë themelore, qershor 2008.

17 Po aty, te neni 3.

18 Kuvendi i Kosovës, *Kodi i Procedurës Penale nr. 08/L-032 (17 gusht 2022)*, gjendet tek <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8750FE73-BA51-463C-BA88-31D0B8865840.pdf> (Qasur më 1 dhjetor 2023). Ligji hyri në fuqi 6 muaj më vonë, më 17 shkurt 2023.

19 Po aty, neni 5.

20 Po aty, neni 8.

21 Po aty, neni 13.

22 Po aty, neni 14.

23 Po aty, neni 62.

24 Po aty, neni 63.

25 Po aty, neni 64.

Korniza ligjore e Kosovës për dhunën në familje është e përcaktuar në mënyrë specifike në Ligjin për barazi gjinore,²⁶ nenin 248 të Kodit penal,²⁷ udhëzimet e nxjerra nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me çështjet e dënimit²⁸ dhe kualifikimi ligjor i veprave të dhunës në familje,²⁹ dhe Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje (LMDHF).³⁰ Neni 13 i LMDHF-së parasheh dy lloje të mbrojtjes: kërkesa për urdhër për mbrojtje (UM) dhe kërkesa për urdhër mbrojtje emergjente (UME). Viktimat e drejtpërdrejta mund të kërkojnë UM, e në situata të caktuara, UM-të mund të kërkojnë nga përfaqësuesi i autorizuar i viktimës, mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i QPS-së. Të njëjtat palë mund të kërkojnë edhe UME, së bashku me këdo që ka marrëdhënie familjare me viktimën, këdo që ka njohuri të drejtpërdrejtë për dhunën në familje të kryer ndaj viktimës, ose ndonjë OJQ e mirëinformuar. Gjykatat duhet të vendosin për UME-të brenda 24 orëve dhe UM-të brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

Në shtator 2023, Kosova ndryshoi një pjesë të konsiderueshme të kornizës ligjore në lidhje me dhunën në familje duke miratuar ligj të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore (Ligji për DHF 2023)³¹ me qëllim të harmonizimit me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).³² Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet në Kodin penal dhe KPP, duke parashikuar dënime më të ashpra për kryerësit e dhunës në familje, si dhe duke i tkurrur afatet për hetimin dhe

26 Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>. 26 qershor 2015 (qasur më 27 mars 2024).

27 Kodi nr. 06/L-074, Kodi penal i Kosovës, neni 248). <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>. 14 qershor 2019 (qasur më 1 dhjetor 2023).

28 Udhëzuesi i Gjykatës Supreme të Kosovës për politikën ndëshkimore (2018) https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing_Guidelines_shkurt_2018.pdf. (Qasur më 1 dhjetor 2023).

29 Udhëzues për kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës (2020). https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/75340_Supreme%20Court%20DV%20Guidance_June%202020.pdf. (Qasur më 1 dhjetor 2023).

30 Ligji Nr. 03/L-182, (2010). <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>. (Qasur më 1 dhjetor 2023).

31 Ligji për DHF ka qenë në fuqi gjatë pjesës më të madhe të periudhës së monitorimit për raportin. Megjithatë, ligji për DHF i vitit 2023 u publikua më 12 tetor 2023; ai hyri në fuqi 15 ditë më vonë, më 27 tetor 2023. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=83131> (qasur më 1 dhjetor 2023).

32 Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi një amendament të Kushtetutës së tij, ku u ratifikua Konventa e Stambollit. Neni 50 i Konventës së Stambollit përshkruan detyrimin e shteteve ratifikuese që të sigurojnë që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të ofrojnë reagim të menjëhershëm, parandalim dhe mbrojtje nëpërmjet masave legislative ose të tjera. Neni 53 i Konventës së Stambollit përshkruan detyrimin e shteteve ratifikuese që "të marrin masat e nevojshme legislative ose të tjera për të siguruar që urdhrat e duhur kufizues apo të mbrojtjes të jenë në dispozicion për viktimat e të gjitha formave të dhunës që trajtohen në fushëveprimin e kësaj Konvente". Pjesa 2 e nenit në fjalë vendos standardet minimale për urdhrat e mbrojtjes, duke përfshirë: që ato të jenë drejtpërdrejt të mundshme; që viktimës të mos i vihet ndonjë barrë e panevojshme financiare ose administrative; të lëshohen për periudha të caktuara, ose derisa të ndryshohen apo hiqen; si dhe të jenë në dispozicion në baza *ex parte*, sipas nevojës. Neni 53 po ashtu kërkon që në rast të shkeljes së urdhrat të mbrojtjes të shqiptohen zbatohen sanksione penale ose të tjera ligjore që janë efektive, proporcionale dhe bindëse.

kohëzgjatjen e gjykimit.³³ Janë miratuar edhe disa dokumente të tjera strategjike në lidhje me dhunën në familje.³⁴

Korniza ligjore ndërkombëtare

Kushtetuta e Kosovës përcakton se disa marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare të renditura janë drejtpërdrejt të zbatueshme, përfshirë këtu KEDNJ-në, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKCP) dhe Konventën e Stambollit.³⁵ Neni 53 i Kushtetutës përcakton më tej që secili interpretim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës duhet të jetë në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.³⁶ Prandaj, ky raport do të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në frymën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Raporti merr praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) si standard kryesor ndërkombëtar që përkufizon të drejtën për liri, të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si dhe të drejta të tjera të përmendura në raport.

GJEDNJ ka luajtur rol të rëndësishëm në njohjen e dhunës në familje si shkelje ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se detyrimet pozitive të autoriteteve sipas nenit 2 të KEDNJ-së (e drejta për jetë), nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) mund të përfshijnë edhe detyrimin për të vendosur e zbatuar në praktikë një kornizë ligjore adekuate që ofron mbrojtje nga aktet e dhunës nga personat privatë. GJEDNJ ka vënë në dukje “cenueshmërinë e posaçme të viktimave të dhunës në familje dhe nevojën për angazhim aktiv të shtetit në mbrojtjen e tyre”.³⁷ Shkelja e nenit 3, që është e drejtë absolute, ngërthen kontroll më të thukët nga Gjykata, e për këtë arsye, është më

33 Më 26 tetor 2023, Kuvendi Kombëtar i Kosovës miratoi ndryshimet në KPP dhe Kodin Penal. Në pjesën përkatëse, kryesisht tashmë nuk mund të kandidojnë për poste publike dhe punësim në sektorin publik; blerjen në ankande të pronave publike, aseteve publike ose licencave, të aplikojnë si investitorë strategjikë dhe patentëshoferë (për shoferë profesionistë).

34 Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/9307CD0A-E63D-4DCE-A93C-39698DE65A2F.pdf> (Qasur më 1 dhjetor 2023); Kurrikula për trajnimin e profesionistëve që punojnë në programet për kryesit e dhunës në familje në Kosovë <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/DFB18A0D-1B6A-47FB-BF26-65C2F0D77977.pdf> (Qasur më 1 dhjetor 2023); Raporti Vjetor i Zbatimit të Strategjisë kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/DE72E004-123A-4E11-AF68-F577319CDC89.pdf> (Qasur më 1 dhjetor 2023); Protokollin Shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/67347A0F-D211-492F-B8CC-3619F43E5484.pdf> (Qasur më 1 dhjetor 2023).

35 Po aty, Neni 22.

36 Kushtetuta e Kosovës, nenet 22 dhe 53, qershor 2008.

37 *Volodina kundër Rusisë*, nr. 40419/19, § 47, 14 dhjetor 2021.

domethënëse se shkelja e nenit 2 ose 14, që janë të drejta që mund të kufizohen, gjegjësisht janë të kualifikuara.³⁸

Për sa i përket gjetjeve specifike të këtij raporti, OSBE thekson jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke sqaruar detyrimet pozitive të autoriteteve shtetërore për të mbrojtur të drejtat e njeriut edhe ndaj veprimeve të personave privatë. Në rastin *Tkheldze*,³⁹ GJEDNJ përmbloodhi dështimin e Gjeorgjisë për ta adresuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave në përgjithësi. Në fakt, dështimi për t'i mbrojtur gratë nga dhuna në familje cenon të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë para ligjit – dhe ky dështim nuk duhet të jetë i qëllimshëm. GJEDNJ ka konstatuar më parë se “pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues i gjyqësorit [që krijon] klimë ... të favorshme për dhunë në familje” përbën shkelje të nenit 14 të Konventës.⁴⁰ Në rastin *Opuz*, Gjykata konstatoi se, pavarësisht reformave të kryera nga qeveria turke në vitet e fundit, mosreagimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe pandëshkueshmëria të cilën e gëzonin agresorët tregonte për angazhim të pamjaftueshëm nga ana e autoriteteve për t'i ndërmarrë veprimet e duhura për adresimin e dhunës në familje. GJEDNJ-ja ka cituar vonesat e shpeshta të gjyqësorit në lëshimin e urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje dhe faktin se “kryerësit e dhunës në familje nuk morën dënime zbrapsëse”.

Trajtimi i tillë diskriminues ndodh kur veprimet e autoriteteve nuk janë thjesht dështim apo vonesë në trajtimin e dhunës në fjalë, por përbëjnë një lloj pranimi të përsëritur të dhunës së tillë, si dhe pasqyrojnë qëndrim diskriminues ndaj ankueses si grua.⁴¹ Reagimi i menjëhershëm ndaj akuzave për dhunë në familje është i obligueshëm për autoritetet, të cilat duhet të përcaktojnë nëse ekziston rrezik real dhe i drejtpërdrejtë ndaj jetës së një apo më shumë viktimave të identifikuar të dhunës në familje, duke bërë vlerësim autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut.⁴²

38 Të drejtat e kualifikuara janë të drejta në të cilat mund të ndërhyhet për të mbrojtur të drejtat e një tjetri ose interesi më i gjerë publik, p.sh. e drejta për jetën private dhe familjare, neni 8. Të drejtat e pakualifikuara janë të drejta që nuk mund të çmohen kundrejt nevojave të individëve të tjerë ose kundrejt ndonjë interesi të përgjithshëm publik. Ato mund t'u nënshtrohen përjashtimeve specifike, p.sh. e drejta për të mos u privuar nga liria, neni 5; ose nuk i nënshtrohen asnjë kufizimi, kur quhen të drejta absolute. *Shih* Pako veglash për informimin e zyrtarëve publikë për detyrimet e shtetit sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. <https://www.coe.int/en/web/echr-toolkit/definitions>. (Qasur më 27 mars 2024).

39 *Tkheldze kundër Gjeorgjisë*, nr. 33056/17, §§ 48-51, 8 korrik 2021.

40 *Opuz kundër Turqisë*, nr. 33401/02, §§ 191 etj., 9 qershor 2009.

41 *Talpis kundër Italisë*, nr. 41237/14, § 141, 2 mars 2017.

42 *Kurt kundër Austrisë*, nr. 62903/15, § 190, 15 qershor 2021.

4. KONSTATIMET NGA MONITORIMI GJYQËSOR

4.1 Mbështetja e tepërt e gjykatave themelore në dënimet alternative dhe analizimi i pamjaftueshëm i rrethanave rënduese dhe lehtësuese në rastet e dhunës në familje

OSBE është e brengosur për mbështetjen e tepruar të gjykatave në dënimet alternative, si dënimet me kusht apo gjobat, gjatë sanksionimit të të pandehurve të dënuar për vepra të dhunës në familje. Është vërejtur gjithashtu se gjykatat shpesh nuk i vlerësojnë në mënyrë adekuate rrethanat përkatëse rënduese dhe lehtësuese në aktgjykimet e tyre. Këto praktika mund të përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kornizës ligjore në Kosovë dhe vetë qëllimit të dënimit, e që është parandalimi i dhunës, kompensimi i viktimave dhe rehabilitimi i kryesit të veprës.⁴³

Veprat penale të dhunës në familje mund të ndiqen si vepra të ndryshme (lëndime të lehta⁴⁴ ose të rënda⁴⁵ trupore, kanosje,⁴⁶ ngacmim,⁴⁷ shkelje e detyrimeve familjare⁴⁸ etj). Për të siguruar krahasim të drejtë e të saktë të praktikave të dënimit, kjo pjesë e raportit i analizon *vetëm* veprat e kualifikuara si dhunë në familje sipas nenit 248 të Kodit penal.⁴⁹ Prej tyre, OSBE i ka analizuar dënimet e shqiptuara në nëntë raste. Gjetjet tregojnë se dënimi me burg u shqiptua në vetëm 22 për qind të rasteve, ndërsa shumica dërmuese e gjyqtarëve (në 78 për qind të rasteve) zgjodhën ose ta gjobitnin kryesin, të aplikonin dënim alternativ (si dënimi me kusht, gjoba me kusht, ose edhe pa gjobë), ose të shqiptonin masa të tjera (të tilla si aktgjykime që kërkojnë trajtim të detyrueshëm psikiatrik). Në rastet ku u shqiptua burgim efektiv, mesatarja e dënimit ishte pak më shumë se pesë muaj, ndërsa mesatarja e dënimit me burgimit me kusht ishte gati gjashtë muaj e gjysmë. Shuma mesatare për gjobat efektive dhe ato me kusht ishte 350€.

43 Neni 38(1) (Qëllimi i dënimeve), Kodi Penal i vitit 2019.

44 *Po aty*, 185

45 *Po aty*, neni 186


46 *Po aty*, neni 181

47 *Po aty*, neni 182

48 *Po aty*, neni 244

49 *Po aty*, neni 248

Llojet e dënimeve të shqiptuara



Pavarësisht mungesës së një standardi ndërkombëtar të parimeve të caktimit të dënimeve, Këshilli i Evropës u ka bërë thirrje shteteve të tij anëtare për konsistencë në dënime, duke rekomanduar që “ashtu siç rastet e ngjashme duhen të trajtohen njësoj, rastet e ndryshme duhet të trajtohen ndryshe, për sa kohë që dallimet arsyetohen mirëfilli”.⁵⁰ Për të arritur njëtrajtshmëri në dënime, duhet të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të veprës penale.⁵¹

Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës ka miratuar Udhëzuesin për politikën ndëshkimore në vitin 2018, si mjet të dobishëm, jodetyrues për gjyqtarët për të arritur uniformitetin në dënime.⁵² Pika 5.8 e Udhëzuesit thekson se, megjithëse gjykatat mund të marrin në konsideratë veprat penale të mëparshme në përcaktimin e ngritjes së nivelit të dënimit, “nëse gjykata rastis në vepra që zakonisht ndërlidhen me situatat e dhunës në familje, *rekomandohet fuqishëm* që të zbatohet kjo dispozitë në mënyrë që të ashpërsohet niveli i përgjithshëm i veprës” (theksi i shtuar). Pika 5.9.3 thekson se gjykata duhet ta shqyrtojë automatikisht rritjen e dënimit nëse kryesi dhe viktimi jetojnë në të njëjtën familje. Në kontekstin e veprave penale të dhunës në familje, gjykatat duhet të shqyrtojnë me kujdes secilin pretendim të provokimit që pohohet si faktor lehtësues dhe të jenë të vetëdijshme se “abuzuesit shpesh e konsiderojnë secilin kërcënim ndaj pushtetit të tyre për ta kontrolluar viktimën si provokim”. Në pikën në fjalë më tutje specifikohet se “deklaratat ose kërkimfaljet nga i

50 Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R(92)17 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me konsistencën në dënime, tetor 1992 (Rekomandimi i KiE-së R(92)17).

51 Përmbledhje ligjore e të drejtave ndërkombëtare të gjyqimit të drejtë, OSBE ODIHR, faqe 192, Konsistenca dhe dënimi bazuar në rrethana lehtësuese dhe rënduese. <https://www.osce.org/files/f/documents/1/f/94214.pdf>

52 Udhëzues për politikën ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës, 2018.

pandehuri duhet të shihen me skepticizëm, pasi pendimi i rremë mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në marrëdhëniet e dhunës në familje".⁵³ Në veçanti, gjykatat duhet ta shohin "me dyshim secilën kërkesë për zbutje të dënimit për shkak të karakterit të mirë" dhe "duhet të marrin parasysh vetëm karakterin e të pandehurit në kontekst të marrëdhënies [me palën e dëmtuar]" pasi shpesh "partnerët abuzues kanë paraqitje të mirë [dhe] janë të aftë që ta ruajnë kontrollin."⁵⁴ Me rastin e shqyrtimit të kërkesës së viktimës për dënim më të butë, gjykata duhet të jetë "jashtëzakonisht e kujdesshme për ndonjë indikacion të dhunës në familje në kuadër të veprës". Gjykatat duhet ta kuptojnë se "pajtimi është pjesë themelore e ciklit të dhunës në rastet e dhunës në familje" dhe se "duhet të vlerësohet në tërësi historia e mëparshme e marrëdhënies".⁵⁵

Duke pasur parasysh këto konsiderata, më poshtë janë dhënë tre shembuj të rasteve në të cilat gjykatat kanë shqiptuar masa mbase tepër të buta me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurve penalë të shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të dhunës në familje – vepër që ngërthen dënim me gjobë dhe burgim deri në tre vjet.

SHEMBULLI I PARË: Në një rast në Gjykatën Themelore në Gjilan, i pandehuri ishte dënuar për ushtrim të dhunës në familje ndaj ish-partneres së tij, nga e cila ishte ndarë tri ditë para incidentit. Në ditën kritike të incidentit, teksa i pandehuri dhe pala e dëmtuar ishin të ulur në veturë, pala e dëmtuar kishte pranuar një telefonatë. I pandehuri kishte kërkuar me forcë që ta dëgjonte bisedën, ishte bërë xheloz kur një shok/shoqe e së dëmtuarës e kishte ftuar për kafe, dhe kishte filluar të bërtiste e ta ofendonte. Më pas, ai e kishte goditur në fytyrë e kokë, si dhe e kishte kapur për flokë. Pala e dëmtuar kishte tentuar të ikte, por i pandehuri e kishte ndjekur dhe e kishte tërhequr zvarrë për flokësh për 10 metra deri tek vetura e tij. Fatmirësisht, atypari po kalonte një zyrtar policor dhe kishte intervenuar; i pandehuri u arratis, por më vonë u kap dhe u arrestua. Gjykata i mori si rrethana lehtësuese: pranimin e fajësisë së të pandehurit, pendimin e tij, premtimin e tij për të mos kryer sërish vepër, si dhe faktin që ai ishte përgjegjës për pagesën e alimentacionit për fëmijët. Gjykata i mori si rrethana rënduese: nivelin e lartë të dashjes së të pandehurit për të kryer veprën penale, faktin që veprën e kishte kryer për shkak të xhelozisë, si dhe faktin që kishte vazhduar me kryerjen e veprës penale edhe pasi e dëmtuara kishte provuar të ikte. Përkundër peshës së madhe të rrethanave rënduese, si dhe fakteve të veprës (duke përfshirë faktin se i pandehuri fillimisht i ishte shmangur arrestimit, si dhe nivelin

53 *Po aty*, pika 6.7.5.

54 *Po aty*, pika 6.4.

55 *Po aty*, pika 6.8.6.

e lartë të kontrollit që ai ishte përpjekur ta ushtronte mbi të dëmtuarën), gjykata i shqiptoi vetëm gjobë prej 500 €, si dhe dënim me kusht prej tetë muajsh.

Ndëshkimi i sjelljes së tillë kriminale me dënim me kusht dhe gjobë mund të shihet si i papërshtatshëm sipas Udhëzuesit për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme, ku thuhet se, për ta marrë në konsideratë pendimin si rrethanë lehtësuese, gjykata duhet ta vlerësojë sinjeritetin e të pandehurit.⁵⁶ Shembuj që gjykata duhet t'i marrë në konsideratë janë edhe fakti nëse i pandehuri ka kërkuar ose ka ofruar menjëherë ndihmë mjekësore për viktimën e dëmtuar, apo edhe sjellja e mëvonshme e të pandehurit, përfshirë "dorëzimi në polici". Udhëzuesi parashtron një pyetje të posaçme: "A ka shfaqur kryerësi pendim si përpjekje për ta bindur viktimën që të llojë për zvogëlim apo heqje të dënimit? A është kjo situatë e dhunës në familje?" Në shembullin e këtij rasti, i pandehuri e ka lënë palën e dëmtuar pa ofruar ndihmë, si dhe është përpjekur t'i shmangej policisë, për ta shmangur arrestimin. Të dyja veprimet peshojnë shumë në anën e kundërt për ta marrë pendimin si rrethana lehtësuese. Në fakt, këto rrethana rënduese me peshë do të duhej të kishin çuar në dënim të konsiderueshëm me burgim efektiv. Më tej, ndërsa gjykata i ka konsideruar detyrimet e të pandehurit për alimentacion të fëmijëve si rrethanë lehtësuese, ajo nuk ka artikuluar nëse i pandehuri dhe pala e dëmtuar kishin kujdestari të përbashkët mbi fëmijën. Në atë rast, "NUK duhet të ketë zbutje për rrethanat familjare të cilat ... vënë anëtarët tjerë të familjes në rrezik"⁵⁷, ndërsa detyrimi i të pandehurit nuk është dashur të konsiderohet si rrethanë lehtësuese.

SHEMBULLI I DYTË: Në një rast para Gjykatës Themelore në Prizren, i pandehuri është dënuar për ushtrim të dhunës në familje ndaj gruas së tij pasi që ai, me të hyrë në dhomën e saj kishte ngritur zërin dhe e kishte ofenduar, duke e tërhequr zvarrë nëpër shtëpi për krahë, këmbë dhe flokë. Pala e dëmtuar kishte arritur t'i largohej dhe ta mbyllte veten dhe vajzën e vogël në tualet. I pandehuri kishte vazhduar ta ndiqte të dëmtuarën dhe, pasi tri vajzat e tjera të tyre u përpoqën ta largonin nga dera, ai i kishte shtyer ato përtokë dhe i kishte tërhequr për flokë. Në aktgjykim e saj, gjykata ka përfshirë si rrethana lehtësuese: sjelljen korrekte të të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, "faktin se është njeri familjar dhe baba i katër fëmijëve", shprehjen e pendimit nga ai, kërkimfaljen publike ndaj të dëmtuarave para gjykatës dhe premtimin e tij se "në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprime të tilla". E vetmja rrethanë rënduese që gjykata e konsideroi në mënyrë specifike ishte se "në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale të dhunës në familje – vepër që kohët e fundit është në rritje në shoqërinë tonë". Më tej, gjykata deklaroi se sjellja kriminale e të pandehurit kishte ardhur si pasojë e "mosmarrëveshjeve të vazhdueshme"

⁵⁶ Po aty, faqe 127-129.

⁵⁷ Po aty, faqe 111-112.

mes tij dhe të dëmtuarës dhe “xhelozisë mes tyre”. Gjykata e dënoi të pandehurin me 13 muaj burgim dhe 400 euro gjobë. Megjithatë, meqë gjykata ishte e detyruar ta llogarisë kohën që i pandehuri kishte kaluar në paraburgim në shqiptimin e dënimit të plotë, i pandehuri përfundimisht nuk u detyrua të vuaj burgim efektiv dhe u detyrua të paguajë gjobë prej 60 euro.

Mbase nuk është për t’u çuditur që i pandehuri e kërcënoi të dëmtuarën menjëherë pasi u lirua nga paraburgimi. Në atë procedurë të veçantë penale, gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për kërcënim dhe mospërfillje të gjykatës dhe e dënoi me dy vjet burgim me kusht dhe gjobë prej 300 euro.

OSBE dëshiron të nënvizojë faktin që gjykata kishte përfshirë konsideratën se i pandehuri “është familjar dhe baba i katër fëmijëve”. Siç u tha më sipër, i pandehuri i kishte sulmuar fizikisht tre prej fëmijëve të tyre fëmijë dhe kishte ushtruar dhunë në familje ndaj të dëmtuarës në sy të fëmijës më të vogël. Udhëzuesi thekson “nëse ka fëmijë të pranishëm në shtëpi gjatë kryerjes së veprës, Gjykata *duhet...* ta analizojë të kaluarën e marrëdhënies dhe ndikimin e saj te fëmija. Edhe nëse vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përfshin ndonjë veprim të drejtuar kundër fëmijës, vetë prania e fëmijës mund të konsiderohet si rrethanë rënduese”⁵⁸ (theksi i shtuar). Më tej, Udhëzuesi specifikon se “dëshmitarët e veprës dhe anëtarët e familjes... mund të konsiderohen viktimat të veprimeve të drejtpërdrejta të kryerësit” dhe se gjykata duhet të marrë parasysh “cenueshmërinë dhe/ose pafuqinë e viktimës(ave)... traumën mendore dhe vuajtjet psikologjike të shkaktuara ndaj viktimës(ave)... [dhe] nëse krimi është kryer nga [...] keqpërdorimi i besimit apo autoritetit.”⁵⁹ Sulmi fizik dhe verbal i të pandehurit ndaj palës së dëmtuar, përpjekjet e tij të vazhdueshme për ta dëmtuar atë në prani të fëmijëve dhe vendimi i tij për t’i sulmuar fizikisht fëmijët kur ata u përpoqën të ndërhyjnë, minojnë në masë të madhe aplikueshmërinë e statusit të tij si “njeri familjar” si rrethanë lehtësuese.

SHEMBULLI I TRETË: Në një rast në Gjykatën Themelore të Prishtinës, i pandehuri është dënuar për dhunë në familje për kanosjen se do ta vriste të birin, në prani të të dëmtuarve⁶⁰ (gruaja dhe i biri i tij). Është me rëndësi të ceket se i pandehuri ishte dënuar më parë për vepër të ngjashme të dhunës në familje.

Përkundër recidivizmit të të pandehurit dhe faktit se ai kishte kryer dhunë në familje në prani të një të mituri, gjykata e dënoi atë vetëm me katër muaj burgim (përfshirë kohën e vuajtur), gjobë prej 1000 euro dhe trajtim (shitesë) të detyrueshëm rehabilitues për abuzim me alkool me kohëzgjatje prej jo më

58 *Po aty*, 76.

59 *Po aty*, 47

60 I pandehuri e kishte bërë kërcënimin në prani të të dëmtuarve dhe në prani të vajzës së tij të mitur.

shumë se dy vjet. Gjykata përmendi pranimin e fajësisë dhe shprehjen e pendimit nga ana e të pandehurit si rrethana lehtësuese, por nuk konstatoi rrethana rënduese. Udhëzuesi thekson faktin që “në situata të dhunës në familje shpeshherë përsëritet vepra” dhe nënvizon “efektin veçanërisht shkatërrues mbi viktimën” që i nënshtrohet veprave të përsëritura penale.⁶¹ Udhëzuesi thekson se ekzistimi i dënimit të mëparshëm penal duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese, duke konstatuar se “dënimet e mëparshme... nuk kanë arritur ta rehabilitojnë ose reformojnë kryerësin”.⁶² Në të vërtetë, në këtë rast duket qartë se dënimi i shqiptuar më parë⁶³ nuk e parandaloi të pandehurin nga përsëritja e veprës kundër të njëjtave viktime. Gjykata është dashur ta shqyrtojë këtë rrethanë rënduese dhe të shqyrtojë dënim në përputhje me ashpërsinë e veprës penale dhe historikun recidivist të të pandehurit.

Në shembujt e rasteve të mësipërme, gjykata nuk ka arritur që para se ta shqyrtojë dënimin t’i vlerësojë si duhet rrethanat rënduese bazë, si p.sh.: nëse ka pasur vepër të përsëritur kundër të njëjtës viktimë(a); mosha e viktimës(ave); dënimet përkatëse të mëparshme penale të personit të dënuar; dhe keqpërdorimin e besimit (duke specifikuar se “abuzimi i pushtetit në marrëdhënie përmes kufizimit të autonomisë së individit tjetër... është shpeshherë komponentë e situatave të dhunës në familje”)⁶⁴. Për më tepër, përkundër Udhëzuesit për politikën ndëshkimore të Gjykatës Supreme, në rastet e dhunës në familje gjykatat kanë vazhduar të shqyrtojnë dënime të cilat janë në joproportionalisht të buta. Kjo pengon jo vetëm qëllimin e sistemit të drejtësisë, por edhe ngre shqetësime nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe mund të rezultojë në humbje të madhe të besimit të publikut. Dënimet e tilla joproportionalisht të buta mund t’i dekurajojnë viktimat nga raportimi i abuzimit: nëse e bëjnë këtë, ato priten t’i bëjnë ballë një procesi gjyqësor të stërzgatur dhe traumatik, me pak shpresë që abuzuesi ndaj tyre të parandalohet nga përsëritja e abuzimit dhe me gjasë të ulët të kompensimit financiar për dëmin dhe shpenzimet (shpenzimet mjekësore, lëndimet fizike, shqetësimet e shëndetit mendor, humbja e kapacitetit për të punuar, humbja e mbajtjes etj.).

4.2 Dështimi i gjykatave themelore për t’i gjykuar rastet e dhunës në familje në kohë

OSBE ngre shqetësimin se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk është duke i respektuar afatet procedurale në rastet e dhunës në familje, duke i lënë viktimat në situata të zgjatura, stresuese dhe potencialisht të rrezikshme. Pas largimit nga

⁶¹ Po aty, 73.

⁶² Po aty, 95

⁶³ Në atë kohë i pandehuri ishte dënuar me gjobë, gjashtë muaj burgim me kusht dhe trajtim të detyrueshëm rehabilitues për varësi nga droga dhe alkooli.

⁶⁴ Po aty, 88.

abuzuesi, pala e dëmtuar përballet me një proces të gjatë të rindërtimit të jetës, gjë që shpeshherë përfshin abuzim pas ndarjes, pasiguri financiare dhe procedura të gjata gjyqësore civile e penale. Dështimi i gjykatave për t'i gjykuar me shpejtësi rastet e dhunës në familje mund t'i vë personat e cenueshëm në situata të rrezikshme dhe të paqëndrueshme për periudha të gjata kohore. Në këtë pjesë, OSBE ka analizuar mbi 50 raste të dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, që janë monitoruar në periudhën 1 janar - 1 dhjetor 2023, përfshirë vepra të cilësuar si sulme të lehta ose të rënda trupore, kërcënime, ngacmime, shkelje të detyrimeve familjare ose dhunë në familje.

KPPK kërkon që gjyqtarët t'u përmbahen afateve specifike kohore, përfshirë kohën prej ngritjes së aktakuzës penale deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar⁶⁵ (30 ditë) dhe kohën për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor⁶⁶ (90 ditë për gjykimet që zhvillohen para gjyqtarit të vetëm, 120 ditë për gjykimet që zhvillohen para trupit gjykues).

Detyrimet e nenit 236 për mbajtjen e shqyrtimit brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës janë respektuar në vetëm 28.6 për qind të rasteve të monitoruara të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore. Nga ngritja së aktakuzës deri te mbajtja e seancës fillestare kanë kaluar mesatarisht 286.2 ditë, me një medianë prej 58 ditësh.

Nga pesë rastet që u proceduan në gjykim gjatë periudhës së monitorimit, afatet e parapara me nenit 310 për përfundimin e gjykimit brenda një afati kohor të caktuar janë respektuar në vetëm 3 sosh. Nga data e ngritjes së aktakuzës deri në fillimin e gjykimit kanë kaluar mesatarisht 80.8 ditë, me një mesatare prej 64 ditësh.

Duke pasur parasysh këto kërkesa, në vijim janë paraqitur tre shembuj ku gjykatat nuk i kanë respektuar afatet procedurale të përcaktuara me ligj.


SHEMBULLI I PARË: Në një rast para Gjykatës Themelore të Prishtinës, i pandehuri ishte akuzuar për kanosje ndaj palës së dëmtuar, ish-bashkëshortes së tij. Pala e dëmtuar kishte deklaruar se gjatë martesës së saj prej disa dekadash me të pandehurin, ai rregullisht e kishte abuzuar fizikisht para fëmijëve të tyre dhe vjehrrës së saj. Sipas aktakuzës, i pandehuri e kishte kërcënuar të dëmtuarën vazhdimisht me vrasje dhe e kishte shantazhuar me fotografi të ndjeshme. Aktakuza u ngrit më 13 janar 2020, kurse shqyrtimi kryesor filloi më shumë se tre vjet më vonë, më 29 maj 2023.⁶⁷ Përkundër këtij hendeku kohor të

65 Neni 236 i KPP-së.

66 Neni 310 i KPP-së.

67 Ky rast më parë ishte kryesuar nga një gjyqtar tjetër para se të ricaktohej.

konsiderueshëm, dita e parë e gjykimit u shty me kërkesë të prokurorit, për shkak të mospërgatitjes së tij. Avokati mbrojtës u dakordua për shtyrjen, por theksoi se një dëshmitar kishte udhëtuar nga jashtë vendit për të dhënë dëshminë e tij këtë ditë në gjykatë, duke shkaktuar shpenzime financiare. Gjykata miratoi kërkesën për shtyrjen e gjykimit, duke caktuar seancat e mëpastajme të gjykimit afërsisht një herë në muaj.⁶⁸ Përkundër pretendimeve se i pandehuri vazhdonte ta kërcënonte të dëmtuarën dhe t'i bezdiste kolegët e saj të punës, seancat e gjykimit që pasuan janë përfunduar para kohe për arsye të ndryshme, mes tyre dreka, prokurori ishte “kujdestar” dhe kishte detyrime të tjera, ose prokurorja mungonte meqë ishte duke u intervistuar për ngritje në detyrë. Gjykimi zgjati plot 193 ditë, pra ndjeshëm përtej kufirit 90-ditor të KPP-së për rastet që procedohen para një gjyqtari të vetëm. Më 13 dhjetor 2023, gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për ngacmim dhe i shqiptoi dënim me kusht prej dy vjetësh.



SHEMBULLI I DYTË: Në një rast në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, një e pandehur është akuzuar për vrasje në tentativë të bashkëshortit të saj, të dëmtuarit. Aktakuza e vitit 2010 pretendon se i dëmtuari e kishte sulmuar fizikisht të pandehurën, fillimisht duke e tërhequr zvarrë për flokë nëpër shtëpi dhe më pas duke e goditur me grushte dhe shkelma në trup. E pandehura ishte rrëzuar sipër sirtarit të kuzhinës, kishte marrë një thikë me të cilën e kishte goditur katër herë burrin e saj dhe, duke besuar se e kishte vvarë, kishte ikur nga shtëpia. Në deklaratën e tij, i dëmtuari kishte thënë se nuk e kishte thirrur policinë dhe nuk kishte kërkuar ndihmë mjekësore meqë nuk e kishte parë të

68 OSBE ka raportuar më parë për praktikën e planifikimit të seancave dhe ka rekomanduar që gjykimet të mbahen në ditë të njëpasnjëshme, ose sa më afër që të jetë e mundur. *Shih Menaxhimi i rasteve penale dhe caktimi i gjyqimeve* (31 tetor 2023) <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/557019> (qasur më 1 dhjetor 2023). *Shih gjithashtu Shtojca I e Planit strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2025 për përmirësimin e qasjes në drejtësi*, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/KJC_Strategic_Plan_on_Access_to_Justice_2022.pdf (qasur më 1 dhjetor 2023).

nevojshme dhe nuk kishte dashur ta raportojë rastin. Seanca fillestare u mbajt më se 13 vjet më vonë, më 25 prill 2023. Koha jashtëzakonisht e gjatë që ka kaluar nga ngritja e aktakuzës deri te seanca e parë është qartas në kundërshtim me nenin 236 të KPP-së, i cili kërkon që seanca fillestare të mbahet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

SHEMBULLI I TRETË: Në një rast në Gjykatën Themelore në Ferizaj, i pandehuri është akuzuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor. Aktakuza, e ngritur më 30 dhjetor 2022, pretendon se pas një mosmarrëveshje verbale me kunatën e tij (palën e dëmtuar) i pandehuri e kishte futur atë me forcë në dhomën e gjumit, e kishte kapur për flokë dhe e kishte goditur disa herë në kokë. I pandehuri e pranoi fajësinë në seancën fillestare të 16 qershorit 2023, seancë kjo që u mbajt 168 ditë pas ngritjes së aktakuzës, në kundërshtim me nenin 236 të KPP-së. Vlen të ceket se kryetari i trupit gjykues e mbajti seancën në zyrën e tij, duke pretenduar se nuk kishte gjykatore të lira, duke e detyruar palën e dëmtuar të ulet një metër larg të pandehurit dhe duke e vendosur atë në pozitë të palakmueshme.

4.3 Mangësitë në zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Koha më e rrezikshme në jetën e një viktime të dhunës në familje është kur ajo vendos të largohet: 77 për qind e vrasjeve të lidhura me dhunën në familje ndodhin pas ndarjes dhe ka rritje të dhunës për 75 për qind për së paku dy vjet pas ndarjes.⁶⁹ Mënyra në të cilën institucionet reagojnë gjatë kësaj periudhe vendimtare mund ta bëjë dallimin mes suksesit ose dështimit, sigurisë ose dhunës, dhe jetës a vdekjes.

Forme e rëndësishme e reagimit janë urdhrat për mbrojtje. OSBE i ka vënë në dukje dhe në të kaluarën vonesat sistematike në nxjerrjen e vendimeve për kërkesat për urdhër mbrojtje.⁷⁰ Siç u përmend më sipër, këto kërkesa janë çështje urgjente dhe duhet të zgjidhen brenda 15 ditëve. Megjithatë, 24 për qind nga 29 rastet e urdhrave civile të mbrojtjes që janë monitoruar në periudhën 1 janar - 1 dhjetor 2023 kanë qenë në kundërshtim me afatet. Mesatarisht, gjykatave iu deshën 11 ditë për të shqyrtuar një kërkesë për urdhër mbrojtje; në rastet kur është shkelur afati, gjykatave iu deshën mesatarisht 27.4 ditë për t'i shqyrtuar kërkesat për UM. Me fjalë të tjera, gjykatat e Kosovës lanë gati një të

69 Shërbimet mbështetëse për gratë të rrahura. *Tetëmbëdhjetë muaj pas largimit nga dhuna në familje është kohë me rrezik.* <https://www.bwss.org/eighteen-months-after-leaving-domestic-violence-is-still-the-most-dangerous-time>. 11 qershor 2022 (qasur më 1 dhjetor 2023).

70 Raporti i OSBE-së *Gjykimi i kërkesave për urdhër mbrojtje në rastet e dhunës në familje në Kosovë*, mars 2012 (qasur më 1 dhjetor 2023).

katërtën e viktimave pa zgjidhje me kohë, duke i ekspozuar ato ndaj dhunës të mëtejshme.

Neni 15 i LMDHF-së kërkon që përfaqësuesi i QPS-së të jetë i pranishëm në çdo seancë dëgjimore për urdhër të mbrojtjes në rastet kur parashtruesi i kërkesës është i moshës nën 18 vjeç, ose kur veprat e supozuara të dhunës kanë ndikim te personi i moshës nën 18 vjeç. Megjithatë, përfaqësuesit e QPS-së nuk arritën të merrnin pjesë në plot 60 për qind të 20 seancave dëgjimore për urdhër mbrojtje që përfshinin persona të moshës nën 18 vjeç. Në rastet kur përfaqësuesi i QPS-së ishte i pranishëm, gjykatat i miratuan 75 për qind të kërkesave për urdhër mbrojtje në krahasim me shkallën e përgjithshme të miratimit prej 68 për qind. Kjo statistikë ilustron vlerën dhe ekspertizën që ofrojnë përfaqësuesit e QPS-së, kur janë të pranishëm. OSBE ka analizuar më parë shkallën në të cilën QPS-të veprojnë në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe parimet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, duke vënë në dukje brengën se QPS-të ose kanë munguar ose nuk kanë dhënë kontribut thelbësor gjatë procedurave gjyqësore.⁷¹

Në një aspekt pozitiv, monitoruesit e gjykimeve nga OSBE-ja nuk kanë vërejtur disa nga mangësitë që kanë qenë të cekura në raportin e vitit 2012.⁷² Për shembull, urdhrat e mbrojtjes tani në përgjithësi specifikojnë se cilat masa mbrojtëse shqiptohen dhe këshillojnë kryerësit se çdo shkelje e urdhrit përbën vepër penale. Në fund, me rastin e shqiptimit të masës së ndalim afrimit viktimës, gjykatat tani në përgjithësi specifikojnë distancën e ndalimit në metra.

71 Raporti i OSBE-së [Fëmijët në radhë të parë: roli i Qendrave për Punë Sociale në proceset gjyqësore qershor 2020](#) (qasur më 1 dhjetor 2023).

72 Shih diskutimin në shënimin 5 më sipër.

5. PËRFUNDIME

Gjatë analizës së rasteve të shqyrtuara nga gjykatat themelore të Kosovës, OSBE ka vërejtur disa mangësi në procedurat e dhunës në familje. OSBE dëshiron t'i vë në dukje zhvillimet konstruktive të cekura më sipër në fushën e masave mbrojtëse dhe thekson se gjyqësori i ka adresuar shqetësimet e OSBE-së të vitit 2012. Përkundër këtij progresi të shënuar, OSBE konsideron se në këtë raport janë evidentuar mangësi për tejkalimin e të cilave kërkohen ndryshime e plotësime shtesë në politikëbërje, si dhe ngritje e kapaciteteve për gjyqësorin.

Në shumicën e aktgjykimeve me të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale dhunë në familje, gjykatat themelore kanë shqiptuar masa shumë të buta, si dënime me kusht, gjoba, apo masa të tjera alternative. Dënimi mesatar me burgim efektiv ishte pak më shumë se pesë muaj, e shuma mesatare e gjobave aktuale dhe atyre me kusht ishte 350 euro. Në rastet e analizuara ishte evidente se gjykatat nganjëherë nuk i vlerësonin si duhet rrethanat lehtësuese të tilla si sinqeriteti apo pendimi i të pandehurit. Veç kësaj, është vënë re se gjykatat nuk i kanë vlerësuar si duhet rrethanat kryesore rënduese, si për shembull nëse personi i dënuar kishte kryer vepra të përsëritura kundër të njëjtës viktimë, moshën e viktimës, dënimet e mëparshme penale të personit të dënuar, si dhe nëse ka ndodhur ndonjë keqpërdorim i besimit. Këto praktika dalin jashtë kornizës së përcaktuar në Udhëzuesin për politikën ndëshkimore të Gjykatës Supreme dhe me gjasë janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.

Krahas kësaj, ekzistojnë afate specifike ligjore që duhen respektuar si në rastet penale ashtu edhe civile të dhunës në familje, duke përfshirë kohën ndërmjet ngritjes së aktakuzës dhe seancës fillestare (që nuk duhet t'i tejkalojë 30 ditë) dhe kohën për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor (që nuk duhet t'i kalojë 90 ditë). Megjithatë, OSBE ka vërejtur se gjykatat themelore nuk arrijnë t'i respektojnë afatet procedurale të përcaktuara me ligj, gjë që, përsëri, është në kundërshtim me kornizën ligjore vendore dhe potencialisht në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të GJEDNJ-së. Për shembull, në rastet e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore, gjykatat kanë respektuar afatin 30-ditor nga ngritja e aktakuzës deri në mbajtjen e seancës fillestare në vetëm 28.6 për qind të rasteve.

Në fund, ka vonesa në procesin e shqyrtimit të kërkesave për urdhër mbrojtje. Në të vërtetë, vlerësimi tregon se gjykatat e Kosovës lanë gati një të katërtën e viktimave pa zgjidhje në kohë, duke i ekspozuar ato ndaj dhunës së mëtejshme. Për më tepër, palët që kërkohet të jenë të pranishme në procedurë civile për UM nuk kanë marr pjesë gjithmonë në seanca.

Sipas ligjit, nëse parashtruesi i kërkesës është nën moshën 18 vjeç ose aktet e supozuara të dhunës përfshijnë një person nën moshën 18 vjeç, në çdo seancë dëgjimore për urdhër mbrojtje duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i QPS-së. Megjithatë, në 60% të rasteve të vëzhguara në Kosovë që përfshinin fëmijë nën moshën 18 vjeçare, QPS-ja nuk mori pjesë në seancat gjyqësore siç parashihet me ligj. Këto brenga jo vetëm që përbëjnë shkelje të dispozitave përkatëse të KPP-së dhe LMDHF-së, por në situata më të rënda, ato mund të ngrenë shqetësime në lidhje me shkelje të neneve 2, 3, 6 dhe 14 të KEDNJ-së.

6. REKOMANDIME

Për Gjykatën Supreme të Kosovës:

- Për të dëshmuar përkushtim të mjaftueshëm se gjyqësori do ta trajtojë dhunën në familje, OSBE inkurajon gjyqësorin që të hartojë një udhëzues plotësues për politikën ndëshkimore në rastet e dhunës në familje, me të cilin promovohet ndëshkimi efektiv dhe proporcional, zvogëlohet recidivizmi, si dhe rehabilitohen kryerësit.

Për Akademinë e Drejtësisë së Kosovës:

- Të ofrohen trajnime të përgjegjshme gjinore për dhunën në familje për gjyqtarët mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, legjislacionin e Kosovës, dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Trajnimet për gjyqtarët të përfshijnë module mbi metodat e dënimeve të njëtrajtshme që i marrin saktë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në të gjitha rastet e dhunës në familje.
- Të ofrohen trajnime për gjyqtarët për procedurat e administrimit efikas të gjykatave në përputhje me KPP-në dhe sipas Planit strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2025.

Për kryetarët e gjykatave themelore dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të siguruar që gjykatat të caktojnë seanca të pandërprera dhe të vazhdueshme për rastet e veprave penale të dhunës në familje.
- Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të siguruar se gjykatat respektojnë afatin kohor 24-orësh për shqyrtimin e kërkesave për urdhra të mbrojtjes emergjente dhe afatin kohor 15-ditor për shqyrtimin e kërkesave për urdhra të mbrojtjes.
- Të minimizohet kontakti mes viktimave dhe të akuzuarve, dëshmitarëve të mbrojtjes ose mbështetësve gjatë seancave dëgjimore, në mënyrë që të shmanget riviktimizimi i palëve të dëmtuara.

Për qendrat për punë sociale:

- Të sigurohet që një përfaqësues i QPS-së t'i shoqërojë viktimat dhe vartësit e tyre në të gjitha seancat dëgjimore për urdhër mbrojtje dhe që t'i mbështesë ata gjatë gjithë procedurës, në përputhje me LMDHF-në.

